



Pranimi / Doretzimi Primijsno/Prodato Received/Deliverty	14. 02 2022	viti god year	2
Organ /Bjësia Organ /Jedinica Org /Unit	8/KM/S/ST/EX	Br Prot Br Prot Prot No	760/2022
		Shtojca Prilog Appendix	
		Sasia Kolicina Quantity	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. Nr.22/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Jeton Koca anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.78/2019, të datës 08.02.2019, së ankuesit me përfaqësues Juridik Avokat me adresë nga Komuna e Prishtinës, sipas Aktgjykimit A. Nr. 885/19, të datës 29.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike " ndërprerjeje e marrëdhënies se punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me A. Nr.78/2019, të datës 08.02.2019, së ankuesit

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.12.2018, ka nxjerr vendim A.Nr. 749/2019, me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, që në afatin prej 15 ditësh të beje shqyrtimin e ankesës së datës 20.09.2018 të ankuesit

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë, me qellim të zbatimit të vendimit të Këshillit, me datë 10.01.2019, me numër protokolli 05-97, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, duke e lenë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi pakënaqur me vendimin e datës 10.01.2019, me numër protokoli 06-97, të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 08.02.2019 me numër protokoli 690/2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur me shqiptimin e masës disiplinor,, ndërprerjeje e marrëdhënies se punës në shërbimin civil”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.03.2019, numër protokoli 1604/2019, ankuesin e ka njoftuar se për shkak të korumit të Këshillit nuk mund të vendos lidhur me ankesën A. Nr. A. nr. 78/2019, e datës 08.02.2019.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 26.03.2019, të Këshillit ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.12.2021, ka nxjerr Aktgjykimi A.nr. 885/2019, me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit si të bazuar në ligj, duke e anuluar njoftimin e datës 26.03.2019, të Këshillit, si dhe duke e detyruar Këshillin që të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 78/2019, e datës 08.02.2019, e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa A. nr. 22/2022, e datës 13.01.2022, sipas Aktgjykimit A. Nr. 885/19, të datës 29.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative; Ankesën A nr.78/209, e datës 08.02.2019, me numër protokoli 690.2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 26.12.2018, me numër A.nr. 749/2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 10.01.2019, me numër protokoli 0697, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Ankesën A nr. 749/2018, e datës 19.11.2018, me numër protokoli 6892/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.09.2018, i Komisionit Disiplinor; Ankesa e datës 20.09.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Informatë shtesë; kërkesa e datës 13.08.2018, për inicimin e procedurës disiplinore tek Komisioni Disiplinor; raporti për vijueshmërinë në punë i datës 10.08.2018; Raporti për prezencën në punë prej datës 01.08.2018, deri me datën 09.08.2018; e -maili i datës 08.08.2018; Procesverbali i datës 10.08.2018; dëshmi nga C.D; Procesverbali i datës 20.08.2018; dërgimi i lendes tek Komisioni i Ankesave i datës 24.09.2018; Ankesa e datës 20.09.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;; konkursi i datës 30.11.2012; Formuari për vlerësimin e rezultateve në Punë; Njoftimi i datës 26.03.20219, i Këshillit; E- maili i datës 09.02.2022; Përgjigje në ankese e datës 23.11.2018, me numër protokoli 05-8067/2, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore se Vendimi i datës 10.01.2019 me numër Nr. prot:05-97 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë se Shëndetësisë është i kundërligjshëm pasi që kishte refuzuar ankesën e ankuesit të datës 20.09.2018 ndërsa kishte lënë në fuqi Vendimin Nr.prot:05-5906 të Komisionit

Disiplinor të datës 04.09.2018 me arsyetimin se shqiptimi i masës disiplinore “Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës në Shërbimi Civil” është bërë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit për Shërbimin Civil dhe akteve tjera nënligjore si dhe në kundërshtim me Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 09.02.2022 përmes e-maili Këshilli i është drejtuar Menaxherit të Njesisë së Burimeve njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike pasi që lënda ishte kthyer në detyrim me vendos sipas Aktgjykimit A.nr.885/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative lidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa Menaxherit i Njesisë së Burimeve Njerëzore përmes e-mailit të datës 09.02.2022 ka informuar Këshillin se ankuesi për shkak së ka qenë jashtë vendi në Gjermani, e ka njoftuar për dorëheqje udhëheqësin e tije përmes telefonit.

Këshilli, pas krijimit të rrethanave të reja lidhur me objektin e shqyrtimit ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 104 ku është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, andaj ne kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e iniciuar nga ankuesi përmes ankesës me numër A.nr.78/2019 të parashtruar me datë 09.02.2019 është bërë i pamundur apo i kotë, respektivisht objekt i shqyrtimit “Ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil e ankuesit” tani më është bërë i pamundur të shqyrtohet pasi që ankuesi për shkak së ka qenë jashtë vendi në Gjermani, e ka njoftuar për dorëheqje udhëheqësin e tije përmes telefonit nga pozita e nëpunësit civil që ka mbajtur në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 22/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Përfaqësuesit avokatit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Gjyqtarit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

